

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7125  
E shtunë, 24 shkurt 2024  
Çmimi 0.50 €

## Bideni takohet me gruan dhe vajzën e Navalnyt

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# OSMANI: ÇËSHTJA E DINARIT E ZGJIDHSHME, S'ËSHTË DASHUR TË SHKAKTONTË PËRPLASJE ME ALEATËT

FAQE 4-5



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë të premtën se çështja e ndalimit të dinarit serb në Kosovë mund të zgjidhet brenda vendit dhe se ajo nuk është dashur të shkaktonte përplasje në

mes të Prishtinës dhe aleatëve të saj. Në një deklaram për medie, Osmani u kërkoi institucioneve të vendit të punojnë për zgjidhjen e kësaj çështje bazuar në ligjet në vend, por me mbështetjen e

aleatëve. "Kjo çështje mund të zgjidhet këtu në Kosovë. Në fakt, nuk është dashur të bëhej çështje fare. Nuk është dashur të krijohet si përplasje me aleatët", tha Osmani

## ÇITAKU: PRESIDENTJA, KRYEMINISTRI DHE MINISTRJA E JASHTME DUHET TË KËNDELLEN URGJENTISHT

F. 3



## MURATI THOTË SE BORXHI PUBLIK ËSHTË NË NIVELIN MË TË ULËT, KUNDËRSHTOHET NGA LDK-JA DHE AAK-JA

F. 7



## OPINION

### VJEDHJA E IDENTITETIT

F. 7

Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA



## AKTUALE



### HOVENIERI: SHBA-ja QËNDRON FUQISHËM KRAH KFOR-it PËR AMBIENT TË SIGURT DHE LIRI TË LËVIZJES NË KOSOVË

F. 3

### PARALAJMËROHET NDËRTIMI I QENDRËS RAJONALE TË EKSELENCËS PËR GRATË, PAQEN DHE SIGURINË

F. 3

## EKONOMI



### KALOI NË SHOYRTIM TË DYTË PROJEKTLIGJI PËR RREGULLAT E REJA NË TRAFIK, PRITET RRRITJA E GJOBAVE

F. 8

### HYKOLLI PRET NË TAKIM PËRFAQËSUESIT E SHOQATËS SINDIKALE TË KUVENDIT, DISKUTOJNË PËR GJENDJEN E TË PUNËSUARVE

F. 8

## SPORT

### KOK-u DHE MKRS-ja MARRIN HAPA KONKRETË KUNDËR DISKRIMINIMIT TË SPORTISTËVE TË KOSOVËS NË ARENËN NDËRKOMBËTARE

F. 10

**RENOVA**  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Bideni takohet me gruan dhe vajzën e Navalnyt

**SAN FRANCISCO, 23 SHKURT** - Presidenti amerikan Joe Biden është takuar në Kaliforni me të venë dhe vajzën e politikanit të ndjerë rus, Aleksei Navalny, tha Shtëpia e Bardhë. Navalny vdiq javën e kaluar në një burg në Arktik. Biden u takua me Yulia dhe Dasha Navalnaya në San Francisco "për t'iu shprehur ngushëllime për humbjen e tyre të tmerrshme", tha Shtëpia e Bardhë përmes një deklarate, duke shtuar se Bideni ka riafirmuar njoftimin paraprak se më 24 shkurt Shtetet e Bashkuara do të vendosin

sanksione të reja kundër Rusisë për shkak të vdekjes së Navalnyt. Gjatë takimit të tij, "presidenti shprehu admirimin e tij për kurajën e jashtëzakonshme të Aleksei Navalnyt dhe për trashëgiminë e tij në luftën kundër korrupsionit dhe për një Rusi të lirë dhe demokratike", u tha në njoftim. Biden "theksoi se trashëgimia e Alekseit do të vazhdohet nga i gjithë populli në mbarë Rusinë dhe mbarë botën që e nderojnë atë dhe luftën e tij për liri, demokraci dhe të drejta të njeriut".

Autoritetet ruse njoftuan më 16 shkurt se Navalny, 47 vjeç, vdiq papritur teksa po mbahej në burg. Navalny, një prej kritikëve më të zëshëm të presidenti rus Vladimir Putin, po vuante një dënim të gjatë për akuza për ekstremizëm që janë cilësuar nga shumë si të nxitura politikisht. Nëna e tij Lyudmila Navalnaya tha të enjten se autoritetet e lejuan që ta shihte trupin e të birit, por tha se ata po tentonin ta "shantazonin" duke i kërkuar ta varrosë të birin në mënyrë sekrete.



## BDI-ja: Qytetarët vërshuan qendrat e KShZ-së në përkrahje të kandidaturës së Bujar Osmanit për president

**SHKUP, 23 SHKURT** - Nga orët e para të mëngjesit të ditës së premte, qytetarë të shumtë në qendrat rajonale të KShZ-së në Kumanovë, Shkup, Tetovë, Gostivar, Dibër, Kërçovë, Strugë, Çashkë dhe anembanë vendit kanë vendosur nënshkrimin e tyre në përkrahje të kandidatit të Bashkimit Demokratik për Integrim për President, Bujar Osmani. Bashkimi Demokratik për Integrim ka falënderuar të gjithë ata që deri më tani kanë shprehur vullnetin e tyre të palëkundur për t'u rreshtuar pas vizionit tonë të dëshmuar të arritjeve të mëdha. Konfirmimi i kandidaturës së Bujar Osmanit përmes këtij grumbullimi masiv të nënshkrimeve, që padyshim se do të tejkalojë numrin prej 10 000 nënshkrimeve, dëshmon



pastërtinë dhe drejtësinë e ideve tona progresive. Ashtu siç realizuam premtimin për kryeministrin e parë shqiptar dhe të gjitha zotimet e faktorizimit tonë kombëtar në këto dy dekadat e fundit, do ta bëjmë realitet edhe kauzën e presidentit të parë shqiptar duke trasuar fillimisht rrugën për realizimin e sigurt të këtij vizioni. Kandidatura e Bujar Osmanit nuk është vetëm akt formal zgjedhor, por një mision i ri madhor, një betejë për ta thyer tabunë e radhës përmes zgjedhjes së presidentit në Kuvend me 2/3 e votave dhe me shumicë të Badenterit. Këtë betejë ashtu si të gjithë të tjerat do ta bëjmë bashkë dhe padyshim se do të ngadhënjejmë në qëllimin tonë të pastër.

## Hungaria bllokoi deklaratën e BE-së për luftën në Ukrainë

**BRUKSEL, 23 SHKURT** - Hungaria ka bllokuar deklaratën e Bashkimit Evropian të cilën blloku është dashur ta lëshojë më vonë gjatë 23 shkurtit lidhur me dyvjetorin e nisjes së pushtimit të përvokuar rus të Ukrainës. Kështu thanë disa burime në Bruksel, që kishin njohuri për këtë proces, me të cilët bisedoi Radio Evropa e Lirë. BE-ja tani po punon në deklaratën që do të lëshohet në emër të tre presidentëve të institucioneve kryesore: Ursula von der Leyen e Komisionit Evropian, Roberta Metsola e Parlamentit Evropian dhe Charles Michel i Këshillit Evropian. Për të lëshuar një deklaratë në

emër të BE-së, të gjithë 27 shtetet anëtare duhet të pajtohen. Budapesti po e kundërshton deklaratën pa dhënë ndonjë shpjegim konkret, thanë zyrtarët e BE-së për REL-in, por një diplomat tha se formulimi i deklaratës "thjesht ishte shumë i fortë për ta [Hungarinë]". Hungaria në vitet e fundit ka refuzuar disa deklarata të BE-së. Rasti i fundit ishte më herët gjatë kësaj jave kur Budapesti tentoi ta bllokonte dakordimin e 26 shteteve të tjera anëtare kundër një operacioni të paralajmëruar ushtarak të Izraelit kundër Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga

Shtetet e Bashkuara dhe BE-ja - në jug të Gazës. Më herët, Hungaria, po ashtu, kishte vendosur veto mbi një deklaratë që kritikonte Kinën, Rusinë dhe Azerbajxhanin lidhur me luftën e këtij të fundit kundër Armenisë. Pavarësisht prej luftës në Ukrainë, kryeministri hungarez Viktor Orban është takuar me presidentin rus Vladimir Putin dhe ka deklaruar se është krenar që komunikon me Moskën, ndonëse diçka e tillë i zemëron liderët e Bashkimit Evropian. Më 24 shkurt bëhen dy vjet që kur Rusia nisi pushtimin e shtetit fqinj, Ukrainës. Lufta ka marrë jetën e dhjetëra mijëra personave,



ka zhvendosur miliona të tjerë dhe ka shkakuar shkatërrim të madh në infrastrukturën e Ukrainës.

BE-ja njoftoi se është pajtuar për një paketë të re të sanksioneve kundër Rusisë për shkak të luftës në Ukrainë.

## Hovenier: ShBA-ja qëndron fuqishëm krah KFOR-it për ambient të sigurt dhe liri të lëvizjes në Kosovë

PRISHTINË, 23 SHKURT - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Jeffrey Hovenier, është takuar të premten me komandantin e KFOR-it, Ozkan Ulutas. Për këtë takim ka njoftuar Hovenier, i cili ka thënë se me Ulutas kanë folur për

situatën e sigurisë në Kosovë, duke shtuar se Shtetet e Bashkuara qëndrojnë fuqishëm krah KFOR-it. "Takimi i mirë me komandantin e KFOR-it, Ulutas. Përsëritëm angazhimin tonë të përbashkët për sigurinë në

Kosovë dhe diskutuam për sfidat aktuale. Shtetet e Bashkuara qëndrojnë fuqishëm me NATO-n/KFOR-in pasi punon për të siguruar një mjedis të qetë dhe të sigurt dhe për lirinë e lëvizjes në Kosovë", ka shkruar Hovenier.



## Paralajmërohet ndërtimi i Qendrës Rajonale të Ekselencës për Gratë, Paqen dhe Sigurinë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 SHKURT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka bërë me dije të premten se, në bashkëpunim me Departamentin Amerikan të Shtetit, në Kosovë do të ndërtohet Qendra Rajonale e Ekselencës për Gratë, Paqen dhe Sigurinë.

Duke folur në Prishtinë në konferencën rajonale "Parlamentarizmi dhe Rezoluta 1325: Perspektivat nga Ballkani Perëndimor", Osmani theksoi se Kosova ka qenë një nga katër shtetet e përzgjedhura për këtë qendër. "Hapja e kësaj qendre në Kosovë është bërë pjesë e strategjisë së ShBA-së për gratë, paqen dhe sigurinë, si dhe pjesë e planit kombëtar amerikan të veprimit", tha Osmani.

Osmani nuk dha hollësi rreth kësaj qendre, apo datë se kur do të ndërtohet ajo, por nënvizoi se ajo pret që përmes saj të



konsolidohen gjithnjë e më shumë partneritete të reja në Kosovë dhe në rajon. Ndërkohë, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, tha se

agjenda për gratë, paqen dhe sigurinë, qëllim kryesor e ka pozicionimin e grave si partnere të barabarta në të gjitha fushat që lidhen me paqen dhe sigurinë.

"Në këtë drejtim, Kosova është shembull i mirë i përkushtimit në përmeshje të agjendave globale, pavarësisht faktit që shpeshherë jemi të kufizuar për

t'i dhënë zë punës tonë në këta organizma që ne ende nuk jemi anëtarë", tha ai. Sipas tij, përfshirja e grave në procese të paqes dhe sigurisë është parakusht për paqe dhe demokraci të qëndrueshme. "Ne sot e kemi një numër të madh të grave të përfshira në politikë, edhe në sektorin e drejtësisë, edhe në atë të sigurisë, ndonëse numri i tyre është larg nga të qenët i barabartë me numrin e burrave dhe kjo duhet të ndryshohet", tha Konjufca.

Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara më 31 tetor 2000 e miratoi rezolutën 1325 për gratë, paqen dhe sigurinë. Kjo rezolutë i nxit shtetet anëtare të OKB-së që të sigurojnë një përfaqësim më të madh të grave në të gjitha nivelet vendimmarrëse në institucionet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare dhe në mekanizmat për parandalimin, drejtimin dhe zgjidhjen e konfliktit.

## Çitaku: Presidentja, kryeministri dhe ministrja e Jashtme duhet të këndellen urgjentisht

PRISHTINË, 23 SHKURT - Nënkyetarja e PDK-së, Vlora Çitaku, ka thënë se Rusia ka filluar në mënyrë agresive ta shtyjë trillimin se Ukraina po bën trafikim të organeve në zonat e luftës. Sipas saj, ambasadat e Rusisë nëpër botë po shpërndajnë "informata" të

tilla nëpër platformat e tyre zyrtare në rrjete sociale. Ish-ambasadorja e Kosovës në ShBA, Çitaku, ka thënë se ky është skenari i njëjtë si me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. "Institucionet tona, presidentja, kryeministri, ministrja e Punëve të Jashtme, duhet të këndellen

urgjentisht. Mosdurimi ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit e Rexhep Selimit nuk duhet t'ua mund dashurinë për Kosovën. Në Hagë sot historia dhe lufta jonë për liri janë braktisur nga shteti", ka shkruar Çitaku në "Facebook".



## Ambasadori i ri i Zvicrës vlerëson partneritetin me Kosovën



PRISHTINË, 23 SHKURT - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të premten në takim ambasadorin e ri të Zvicrës në Kosovë, Jurg Sprecher, i cili shoqërohej nga zëvendësambasadori Christoph Fuchs.

Në takim, veç të tjerave, u bisedua për marrëdhëniet e shkëlqyeshme dypalëshe dhe për mundësitë e avancimit të mëtejshëm të bashkëpunimit

ndërmjet dy shteteve tona. Konjufca e uroi ambasadorin Sprecher për detyrën dhe i dëshiroi mirëseardhje. Njëherësh i shprehu mirënjohje për kontributin e shquar dhe mbështetjen e gjithanshme të Zvicrës mike ndaj Kosovës në të gjitha proceset e shtetndërtimit, zhvillimit, integritetit dhe anëtarësimit në organizata ndërkombëtare, si dhe nënvizoi rëndësinë që kjo mbështetje të

vazhdojë edhe në të ardhmen. Ambasadori Sprecher e falënderoi kryetarin e Kuvendit për pritjen dhe vlerësoi partneritetin dhe raportet e ngushta dypalëshe. Kryetari Konjufca dhe ambasadori Sprecher ritheksuan gatishmërinë për thellimin e mëtejshëm të marrëdhënieve në fusha të ndryshme bashkëpunimi në mes të Republikës së Kosovës dhe Zvicrës.



## Osmani: Çështja e dinarit e zgjidhshme, s'është dashur të shkaktonte përplasje me aleatët

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë të premten se çështja e ndalimit të dinarit serb në Kosovë mund të zgjidhet brenda vendit dhe se ajo nuk është dashur të shkaktonte përplasje në mes të Prishtinës dhe aleatëve të saj. Në një deklaram për medie, Osmani u kërkoi institucioneve të vendit të punojnë për zgjidhjen e kësaj çështje bazuar në ligjet në vend, por me mbështetjen e aleatëve. “Kjo çështje mund të zgjidhet këtu në Kosovë. Në fakt, nuk është dashur të bëhej çështje fare. Nuk është dashur të krijohet si përplasje me aleatët”, tha Osmani

**EPOKA  
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 23 SHKURT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë të premten se çështja e ndalimit të dinarit serb në Kosovë mund të zgjidhet brenda vendit dhe se ajo nuk është dashur të shkaktonte përplasje në mes të Prishtinës dhe aleatëve të saj. “Kjo çështje mund të zgjidhet këtu në Kosovë. Në fakt, nuk është dashur të bëhej çështje fare. Nuk është dashur të krijohet si përplasje me aleatët”, tha Osmani të premten për medie. Rregullorja e re e Bankës Qendrore të Kosovës, që parasheh euron si valutën e vetme në Kosovë për kryerjen e

pagesave me para të gatshme, hyri në fuqi më 1 shkurt. Shtetet e Bashkuara e kanë kundërshtuar zbatimin e rregullores së BQK-së, duke thënë se ajo është miratuar pa konsultime paraprake dhe pa marrë për bazë ndikimet negative që mund të ketë te popullata serbe në Kosovë, e cila që nga paslufta ka përdorur dinarin serb. Çështja e ndalimit të dinarit serb i ka tendosur marrëdhëniet mes Qeverisë së Kosovës dhe ShBA-së. Uashingtoni i ka kërkuar qeverisë së kryeministrit Albin Kurti ta shtyjë zbatimin e rregullores, por Kurti ka insistuar se kjo rregullore nuk do të zhbëhet. Ndihmësekretari amerikan i

Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, James O'Brien, ka thënë se ShBA-ja mund të mos e trajtojë Kosovën si partnere nëse ajo merr vendime pa u konsultuar me të, ndërsa ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeff Hovenier, ka theksuar se çështja e dinarit veçse ka ndikuar në cilësinë e marrëdhënieve në mes të ShBA-së dhe Qeverisë së Kosovës. BQK-ja ka thënë se rregullorja do të zbatohet përmes një tranzicioni të lehtësuar, që do të zgjasë jo më shumë se tre muaj. Ndërkaq, nga ekzekutivi i Kosovës kanë thënë se së shpejti do të dalin me një listë prej dhjetë masash lidhur me mënyrat se si qytetarët të mos dëmtohen gjatë fazës kalimtare

të zbatimit të vendimit. Osmani u kërkoi institucioneve të vendit të punojnë për zgjidhjen e kësaj çështjeje bazuar në ligjet në vend, por me mbështetjen e aleatëve. “Jam e bindur se nëse ka vullnet për një takim i cili mund të zgjasë vetëm disa orë, mund të ulen të gjitha institucionet që do ta zbatojnë në praktikë rregulloren e BQK-së dhe të dalin me hapa konkretë duke u bazuar në ligjet që ekzistojnë në Kosovë dhe ta marrin edhe mbështetjen e aleatëve për zbatimin e saj”, tha Osmani. Të enjten presidentja Osmani u takua me ambasadorin amerikan Hovenier për të biseduar për propozimet që, sipas saj, ofrojnë “një zgjidhje të qëndrueshme për planin e tranzicionit për zbatimin e rregullores së Bankës Qendrore të Kosovës”. Në njoftimin për media të Presidencës së Kosovës, megjithatë nuk u bë me dije se për çfarë propozimesh Osmani ka biseduar me Hovenierin gjatë takimit të tyre të rregullt. Shteti serb ndan miliona euro

për serbët në Kosovë pasi ua paguan atyre - përmes një sistemi paralel - rrogat, pensionet dhe ndihmën shtesë. Në vende të caktuara në Graçanicë, qytetarët serbë më 20 shkurt nuk kanë mundur ta marrin ndihmën sociale dhe shtesat për fëmijë në postë, që punon sipas sistemit serb, sepse punonjësit u kanë thënë se nuk kanë para për t'i paguar këto shtesa. Po më 21 shkurt një grup i mësimdhënësve në Mitrovicë të Veriut protestuan para Kursimores së Postës së Serbisë, pasi nuk morën pagat. Beogradi e ka kritikuar ashpër rregulloren e BQK-së, duke e interpretuar si synim të Qeverisë së Kosovës për dëbim të serbëve. Presidentja Osmani për medie ka folur edhe lidhur me dialogun Kosovë - Serbi dhe kritikën që i janë bërë Kosovës për jokonstruktivitet në këtë dialog. Osmani tha se dialogun më së shumti e ka dëmtuar mungesa e balancit dhe e ekuilibrit ku njëra palë, Kosova, është nën

# Jemi të vegjël shumë për të ekzistuar të vetëm



Shkruan:  
Muharrem NITAJ

Pse po sulmohet kaq ashpër kryeministri se po i prish marrëdhëniet me partnerët strategjikë, posaçërisht ShBA-në.

Cila është narrativa e këtyre përplasjeve dhe çka i thuhet popullit dhe çka nuk i thuhet atij.

Pse ai ka zgjedhur një diskurs të çuditshëm të justifikimit të vendimeve të tij, duke e thënë vetëm gjysmën e të vërtetës.

Nisi atje e filloi, kur ai deklaronte se qytetarët serbë duhet t'i përdorin targat RKS, dhe kjo dukej aq normale sa që njerëzit me të drejtë e arsyetonin vendimin e tij. Por ai nuk tregonte se çështja e targave nuk ishte veç një masë ordinere administrative shtetërore dhe vendimi i pakoordinuar për targat, mund të shndërrohej në problem sigurie, siç edhe ndodhi.

Vendimi i pakoordinuar për to, reflektoi me largimin e serbëve nga institucionet dhe kjo ndoshta ishte përplasja e parë e

tij me partnerët strategjikë të Kosovës.

Përplasja e tij e dytë me aleatët ishte menaxhimi i gjendjes së krijuar pas zgjedhjeve në veri dhe ruajtja me polici e kryetarëve në objektet e komunave. Dhe po, s'ka njeri normal që nuk i mbështetë zgjedhjet në çdo cep të vendit, prandaj edhe krijohej përshtypja se kryeministri po vepronte drejtë. Por nuk thuhet se mbajtja e zgjedhjeve atje ku do t'i bojkotonin shumica e qytetarëve, sërish do të mund të shndërrohej në problem sigurie, siç edhe ndodhi. Qytetarët serbë, si gjithmonë të mbështetur nga regjimi në Serbi, e bënë hallakam veriun dhe faji

na u ngop neve.

Përplasja e tretë e madhe e kryeministrit me partnerët po ndodh me dinarin.

Edhe në këtë rast, nuk ka njeri me dy fije mend që mund të thotë se vendimi që Kosova ta ketë vetëm një valutë zyrtare, nuk është vendim i drejtë.

Por kryeministri e askush prej tyre, nuk po thonë se edhe kjo çështje, nëse nuk bëhet me koordinim të plotë e me një agjendë kohore, mund të shndërrohet në problem sigurie...

Dhe sa herë që një çështje ordinere shndërrohet në problem sigurie, e kjo ka ndodhur shumë shpesh në këto dy vjetët e fundit, barra më e

madhe u bien aleatëve, sepse ata vazhdojnë të jenë garantët kryesorë të sigurisë në vend.

Kryeministri shpesh thotë se "me partnerët edhe mund të mos pajtohemi për gjithçka". Edhe kjo është e drejtë, sepse është krejt normale që të mos pajtohesh me të gjithë e për gjithçka. Por ai nuk tregon se me aleatët nuk po pajtohet në temat për të cilat nuk do të duhej të kishte mospajtime e aq më pak përplasje, në siguri. Çështjet e sigurisë sot janë shndërruar në çështje globale edhe për shtete shumë të fuqishme, të cilat janë liderë rajonalë e kontinentalë, e lere më për Kosovën e vogël. Ne jemi të vegjël për të ekzistuar të vetëm.

## BE-ja sërish kërkon që çështja e dinarit të zgjidhet në dialog

PRISHTINË, 23 SHKURT - Bashkimi Evropian ka përsëritur se dëshiron t'u ndihmojë Kosovës dhe Serbisë të gjejnë një zgjidhje për çështjen e përdorimit të dinarit serb në Kosovë pas hyrjes në fuqi të rregullores së Bankës Qendrore të Kosovës, që parasheh euron si valutë të vetme për pagesa me para të gatshme në shtet.

Zëdhënësi i BE-së për çështje të jashtme dhe sigurisë, Peter Stano, megjithatë gjatë konferencës për media më 23

shkurt, nuk dëshiroi të japë detaje rreth një takimi të thirrur për javën e ardhshme në Bruksel për këtë çështje. "Duhet t'i kthehemi praktikës së deritanishme që të mos flasim në publik dhe konferenca për shtyp për logjistikën e përgatitjeve të takimeve në nivel të grupeve punuese", tha Stano.

Ndërkaq, kryenegociatori i Kosovës, Besnik Bislimi, më herët gjatë javës ka konfirmuar se zyra e tij ka pranuar një ftesë nga BE-ja për takim për çështjen

e dinarit. Ai ka thënë se nuk do të marrë pjesë në këtë takim, duke theksuar se nuk e di se kush mund të marrë pjesë në të nga Kosova. "Dërguam letrën për palët dhe sqaruam në detaje se si presim të merren me çështje të caktuara. Ne shpresojmë që të dyja palët do të gjejnë zgjidhje për një çështje që ishte krijuar me një vendim pa afat dhe pa konsultime të njërës palë, që pati ndikim të pala tjetër", tha Stano. "Ne nuk jemi komentues, por lehtësues dhe bëjmë përpjekje

t'u ndihmojmë palëve që të gjejnë zgjidhje", shtoi ai.

Duke u përgjigjur në pyetjen se çfarë pasojash mund të ketë për Kosovën nëse nuk merr pjesë në takim në Bruksel, të cilin e ka thirrur i dërguari i posaçëm evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Mirosllav Lajçak, Stano tha se "nuk mund të spekulojmë se çfarë do të ndodhë, nëse do të ndodhë", duke shtuar se ftesat për palët janë dërguar dhe BE-ja vetëm bën përpjekje për gjetjen e një zgjidhjeje.

Më herët është konfirmuar se Lajçaku u ka dërguar ftesë Kosovës dhe Serbisë që të marrin pjesë në një takim në Bruksel më 27 shkurt për të diskutuar rreth çështjes së dinarit.

Bislimi gjatë një deklarimi për media kishte thënë se kjo ftesë e Lajçakut përbënte shkelje të parimeve nga ana e tij sepse, sipas praktikave të mëhershme, asnjë temë nuk mund të vendoset në agjendë të një takimi pa pajtimin paraprak të të dyja palëve.



masa tërësisht të padrejta, ndërkaq Serbia, përkundër aktit të agresionit, nuk ka pësuar asnjë masë të vetme.

Presidentja tha se në suaza më të gjera i inkurajon të gjitha institucionet dhe politikanët t'i ruajnë raportet me miqtë. "Në suaza më të gjera të relacioneve me miqtë tanë, unë i inkurajoj të gjitha institucionet e

Republikës së Kosovës, secilin që merret me politikë, që të bëjë çmos që këto relacione, në veçanti me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretërinë e Bashkuar, shtetet e BE-së t'i konsiderojnë jo vetëm të rëndësishme, por ekzistenciale për suksesin e shtetit tonë...", u shpreh presidentja Osmani.

E para e shtetit tha më tutje se

Kosova është shtet me demokraci të konsoliduar e zhvilluar, por nuk duhet të harrohet që kemi probleme të mëdha të sigurisë. "Në këto sfida na duhen partnerët dhe aleatët tanë jo vetëm si shenjë falënderimi që e kanë bërë në të kaluarën, por edhe si vizion se çfarë na duhet në të ardhmen. Kosova nuk mund të ecë përpara vetë, në fakt

asnjë shtet në botë nuk mund të ecë para vetë", u shpreh Osmani. Ajo përmendi edhe fjali të presidentit amerikan Joe Biden dhe sekretarit Antony Blinken për rëndësinë e partneritetit dhe aleancave. "Edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në çdo fjalim të presidentit Biden dhe sekretarit Blinken, do ta vëreni narrativën 'ne duam të punojmë

së bashku me partnerët dhe aleatët tanë'. Dhe kur kjo është e vërtetë për superfuqinë botërore, Amerikën, është miliona herë më shumë e vërtetë për një shtet si Republika e Kosovës", tha presidentja Osmani.

Osmani më tej theksoi se nëse duan që shteti të ketë suksese në rrugën përpara atëherë duhet të bëhet me aleatët.

## Në mars fillon vlerësimi multidisiplinar i fëmijëve në kryeqytet

PRISHTINË, 23 SHKURT - Nga marsi të gjithë fëmijët e kryeqytetit mund të vlerësohen falas nga psikologu, logopedi dhe ergoterapeuti në Qendrën Kryesore të Mjekësisë

Familjare në Prishtinë. Vlerësimi multidisiplinar përfshin vlerësimin e aftësive të përgjithshme, komunikuese si dhe psiko-sociale të fëmijës. Komuna e Prishtinës ka njoftuar se ky vlerësim do të

bëhet nga një ekip i profesionistëve ku përfshihen psikologu, logopedi dhe ergoterapeuti. "Më pas ky ekip profesionistësh mund t'i adresojë nevojat e pacientit, nëse duhet trajtim tutje.

Prindër, edukatorë dhe mësues, ju lutemi, nëse vëreni që fëmijët kanë nevojë për vlerësim të tillë, orientohuni për termin në QKMF - Prishtinë", ka njoftuar komuna e Prishtinës.



## Arrestohet trafikuesi i narkotikëve dhe konfiskohen mbi 33 kg marijuanë



PRISHTINË, MË 23 SHKURT - Policia e Kosovës, Sektori i Hetimeve nga Departamenti për Kufi, gjatë realizimit të një plani operativ, më 22 shkurt, në bjeshkët e fshatit Vermicë ka vërejtur dy persona të dyshuar duke hyrë nga territori i Republikës së Shqipërisë në territorin e Republikës së Kosovës përmes rrugëve malore në mënyrë të paligjshme.

Personat e lartcekur janë vërejtur se gjatë lëvizjes në shpinë bartnin ngarkesa të dyshuara. Pasi kishin hyrë në zonën e Republikës së Kosovës, nga zyrtarët policorë janë

urdhëruar të ndalohen, mirëpo të njëjtit kanë lëshuar ngarkesat që bartnin dhe kanë filluar të ikin. Njëri nga ta është ndaluar nga ana zyrtarët policorë.

Ngarkesa e dyshuar ndodhej në dy çanta me 11 paketime në sasi prej 33 800 kg, substancë e dyshuar narkotike e llojit marijuanë.

Lidhur me rastin është konsultuar prokurori kompetent dhe rasti i kompletuar së bashku me substancën e dyshuar i dorëzohet Drejtorisë për Hetimin e Trafikimit të Narkotikëve Prizren për trajtim të mëtutjeshëm.

## Kryetari i Malishevës mbledh Këshillin e Drejtorëve, kërkon angazhim maksimal në realizimin e projekteve

MALISHEVË, 23 SHKURT - Nën drejtimin e të parit të komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, është mbajtur mbledhja e radhës e Këshillit të Drejtorëve komunalë. Në këtë mbledhje, ku i pranishëm ishte edhe nënkryetari Vesel Krasniqi, përveç raportimit që është bërë nga ana e drejtorëve lidhur me realizimin e planeve të punës së drejtorive përkatëse, është diskutuar edhe lidhur me performancën

komunale, me theks të veçantë për disiplinën në vendin e punës. Kryetari Kastrati ka kërkuar nga drejtorët angazhim edhe më të madh në funksion të realizimit të politikave të qeverisjes komunale dhe ka theksuar se administrata komunale duhet të jetë edhe më e përkushtuar për ofrimin e shërbimeve sa më cilësore për qytetarët tanë.



## Shpërndahen 300 pako ushqimore për familjet nevojtare në Podujevë



PODUJEVË, 23 SHKURT - Në Podujevë është bërë shpërndarja e 300 pakove ushqimore nga organizata "Qatar Charity" për familjet me gjendje të rëndë ekonomike.

Përzgjedhja dhe ndarja e pakove ushqimore është bërë nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në

bazë të regjistrave që ka kjo drejtoria për familjet me gjendje të rëndë ekonomike dhe me asistencë sociale.

Komuna e Podujevës falënderon organizatën nga Katari për donacionet e vazhdueshme që ka dhënë për qytetarët e Podujevës dhe institucionet lokale për financimin e projekteve të ndryshme.

## Komuna e Skenderajt shpërndan motokultivatorë me frezë për 71 bujq

SKENDERAJ, 23 SHKURT - Në komunën e Skenderajt është bërë shpërndarja e motokultivatorëve me frezë për 71 bujq përfitues nga thirrja publike e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, të cilët janë përzgjedhur nga komisioni përkatës i vlerësimit të

aplikacioneve. Kryetari i komunës, Fadil Nura, i pranishëm në ceremoninë e ndarjes së pajisjeve bujqësore, duke i përgëzuar bujqit përfitues, ka siguruar se mbështetja e komunës së Skenderajt për sektorë të bujqësisë do të vazhdojë edhe këtë vit, me

qëllim të rritjes dhe zhvillimit të bujqësisë.

Edhe drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Behxhet Maliqi, i ka përgëzuar fermerët përfitues të motokultivatorëve me freza, duke shtuar se ky projekt po realizohet në bashkëpunim me Islamic Relief Kosova.



## Reçica dhe Xhaka priten në takim nga mbështetësi i fuqishëm i Kosovës, Reto Nause

PRISHTINË, 23 SHKURT - Drejtori i Departamentit për Diasporë të PDK-së, deputeti Elmi Reçica, së bashku me kryetarin e Degës së PDK-së në Zvicër, Ragip Xhaka, janë pritur në një takim nga drejtori i Departamentit për Siguri dhe Atom, Reto Nause, i cili njëherësh është edhe anëtar i Komisionit Parlamentar për Siguri dhe Financa si dhe

deputet i parlamentit nacional. Reçica ka bërë me dije se ata bashkëbiseduan për bashkëpunimin ndërmjet dy shteteve tona si dhe për mërgatën tonë në Zvicër. "Së bashku me kryetarin e Degës së PDK-së, mikun tim Ragip Xhaka, u mirëpritëm nga miku dhe mbështetësi i fuqishëm i Kosovës, drejtori i

Departamentit për Siguri dhe Atom z. Reto Nause i cili njëherësh është edhe anëtar i komisionit parlamentar për siguri dhe financa si dhe deputet i parlamentit nacional. Me të bashkëbiseduam për bashkëpunimin ndërmjet dy shteteve tona si dhe për mërgatën tonë në Zvicër", ka shkruar Reçica në "Facebook".



## Murati thotë se borxhi publik është në nivelin më të ulët, kundërshtohet nga LDK-ja dhe AAK-ja



PRISHTINË, 23 SHKURT - Shifrat e borxhit publik për vitin 2023 kanë nxitur polemika në mes të ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, dhe deputetëve të opozitës. Në mbledhjen e Komisionit për Buxhet, në të cilin ka raportuar Murati dhe përfaqësues të Doganës së Kosovës dhe Administratës Tatimore lidhur me realizimin e të hyrave për vitin 2023, ministri ka thënë se borxhi publik është në nivelin më të ulët në Evropë. "Sa i përket kësaj pike për borxhin publik, mund të them se si Qeveria e Republikës së Kosovës jemi munduar ta stabilizojmë borxhin publik, madje në vitin paraprak kemi pasur rënie në vlerë absolute të borxhit në krahasim me vitin 2022 dhe, për më tepër, rënia është theksuar edhe me tej në terma

relativë, pra kur krahasohet si borxh ndaj bruto prodhimit vendor. Nëse flasim me shifra konkrete, pra borxhi ndaj GDP-së në vitin e kaluar është mbyllur me 17.2 për qind e GDP-së në krahasim me vitin 2020 që ka qenë 22.44 për qind. Nëse shihet trajektorja që nga viti 2020 e këndeje, ka pasur rënie të vazhdueshme të borxhit publik, pra vitin e fundit sidomos ka pasur rënie edhe në vlerë absolute, duke reduktuar kryesisht vlerën e letrave me vlerë të emetuara nga qeveria", ka thënë Murti. Deklarimi i ministrit Murati për ulje të borxhit ka nxitur reagim të deputetit Avdullah Hoti, i cili ka thënë se borxhi publik vetëm është mirëmbajtur dhe nuk ka pasur përmirësim të performancës. Sipas Hotit, nuk mund të merret referencë viti 2020 i pandemisë pasi në atë kohë

është rritur kreditimi dhe ka qenë në rritje shkak i situatës së jashtëzakonshme. Ai ka thënë se 17 për qind e GDP-së ka qenë borxhi edhe në vitet paraprake. "Nëse e merreni vitin 2019, që besoj duhet të merret. Sot kemi 462 milionë euro më shumë borxh publik. Nuk po them se është keq, por t'i citojmë shifrat saktë. Nuk ke ulje në borxhin publik, por e ke mirëmbajtur një praktikë të mirë, të etabluar nga Qeveria e Kosovës në mbështetje të partnerëve ndërkombëtarë, Fondit Monetar në veçanti. Bile ti ke qenë një ndër personat kyç në huazimet gjatë qeverive të kaluara. Puna jote në borxhin publik shenjë nuk ia ka lënë këtij vendi. Asgjë nuk ke bërë. 17 për qind e ke gjetur", ka thënë ai. Hoti i është drejtuar ministrit Murati që ta lë ironinë më të

pasi, siç ka thënë, nuk është duke u munduar poshtëroje askënd. Hoti ka kërkuar sqarime pse nuk është bërë vlerësim kreditor. Ministri Murati ka thënë se në vitin 2023 janë disbursuar 102.4 milionë nga 692 milionë të ratifikuar. Sipas tij, në vitin 2023 në Kuvend janë ratifikuar kredi në vlerë afro 300 milionë euro. Murati ka thënë se janë duke ndërtuar një historik për një trend të menaxhimit të mirë të kredisë. Për këtë ka ndërhyrë Hoti, duke thënë: "mos me mua kështu, se kjo është diskutuar gjatë kohës sa kam qenë ministër dhe e kemi diskutuar se a të bëhet atë vit apo vitin tjetër". Hoti ka vazhduar të bëjë pyetje për ministrin Murati: "Pse nuk bëhet vlerësimi i kostos kreditore kur është diskutuar të bëhet më 2017. A e di sa

humbjen e ka ekonomia e Kosovës shkak i kësaj?". E Murati ka thënë se do ta bëjnë këtë dhe do të bëhet për herë të parë. E pas kësaj, Hoti ka thënë se Murati nuk do të jetë ministër më pasi, sipas tij, mandati i shkojë. Edhe deputeti Pal Lekaj nga AAK-ja ka thënë se nuk ka pasur trend të zvogëlimit të borxhit, por vetëm mirëmbajtje. "Borxhi publik i Kosovës është më i ulët në rajon jo fal kësaj qeverie, por çdoherë ka qenë kështu. Unë nuk mendoj se ju duhet të krenoheni që keni ulur borxhin. Juve ju mungon disbursimi i mjeteve në investime kapitale. E di që keni vështirësi në marrëveshje. Ju e keni mirëmbajtur borxhin. Nuk mund të na shitës që ka pasur suksese të kësaj qeverie", ka thënë Lekaj.

## Arrestohet një person në Prishtinë, kërkohet me 14 urdhëresa të gjykatës

PRISHTINË, 23 SHKURT - Një person është arrestuar nga njësitet e Stacionit Policor Veriu në Prishtinë, i cili kërkohet me urdhëresa të

gjykatës. Sipas një njoftimi për media të policisë, ndaj personit të dyshuar me inicialet V. M., 27 vjeç, kanë qenë aktive 14

urdhëresa, prej tyre 6 urdhëresa me burgim, (6 vjet e tre muaj burgim), për veprat vjedhje e rëndë, kanosje dhe lëndim trupor.

Ndërkaq, pas përfundimit të procedurave të nevojshme policore, personi është dërguar në vuajtje të dënimit.



## Hykollin pret në takim përfaqësuesit e Shoqatës Sindikale të Kuvendit, diskutojnë për gjendjen e të punësuarve

PRISHTINË, 23 SHKURT - Kryetari i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, Atdhe Hykollin, ka pritur në takim përfaqësuesit e Shoqatës Sindikale të Kuvendit të Kosovës (ShSKK), Salihe Salihu, Naim Gjoshi dhe Muhamet Morina. Përfaqësuesit e Shoqatës Sindikale të Kuvendit të Kosovës (ShSKK), kryetarja Salihe Salihu, nënkryetari për organizim Naim Gjoshi dhe sekretari Muhamet Morina, e informuan

Hykollin për organizimin sindikal në Kuvendin e Kosovës dhe shprehën dëshirën të jenë pjesë e BSPK-së. Hykollin u zotua se bashkëpunimi i mirëfillt sindikal në Kosovë fuqizon vendin tonë e njëkohësisht ngrit mirëqenien ekonomike dhe sociale të të punësuarve duke ua mbrojtur të drejtat dhe duke i përfaqësuar para partnerit social. Në takim u diskutua edhe për

gjendjen e të punësuarve dhe për gjetjen e rrugëve ligjore të veprimit sindikal që ngritin po edhe që ruajnë mirëqenien ekonomike dhe sociale të të punësuarve në vendin tonë, për Ligjin e Pagave dhe për Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive. Sidomos u diskutua për dialogun social dhe hapjen e kanalit të shëndetshëm të komunikimit sindikatë - partner social.



## Katari i interesuar për investime në Kosovë



PRISHTINË, 23 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur në takim ambasadorin jorzident të Shtetit të Katarit në Kosovë, Jabor Ali Hussein Al Hawashela Al Dosari. U diskutua për marrëdhëniet bilaterale dhe mundësitë për t'i thelluar ato. Ambasadori Al Dosari ka theksuar gatishmërinë dhe vullnetin e tij dhe të shtetit të Katarit për ta thelluar bashkëpunimin me Republikën e Kosovës, veçanërisht në fushën ekonomike. Ai shprehu interesim në lidhje me ankandet e energjisë së ripërtërishme që kanë filluar të zhvillohen në Kosovë. Ambasadori vlerësoi se këto ankande janë një mundësi e mirë konkurruese për bizneset e

Katarit. Temë tjetër e diskutimit ishte edhe Fondi Sovran, duke qenë se Katarit ka vetë një fond sovran. Kurti e ka informuar ambasadorin për ligjin e miratuar në Kuvend për themelimin e Fondit Sovran në Kosovë, që përbën hapin e parë drejt ndërtimit të strukturës organizative të Fondit. Në bisedë e sipër u theksua dëshira për bashkëpunim në fushën e kulturës dhe turizmit. Në këtë drejtim, kryeministri shprehu interesimin e Kosovës për të krijuar një partneritet në këto fusha në të mirën e dy shteteve. Ambasadori Al Dosari ka theksuar se Katarit e sheh Kosovën si një vend premtues për investime dhe bashkëpunim të pasur në interes të të dyja palëve dhe bizneseve të tyre.

## Kalon në shqyrtim të dytë Projektligji për rregullat e reja në trafik, pritjet rritja e gjobave

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 23 SHKURT - Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka njoftuar për kalimin në Kuvendin e Kosovës të shqyrtimit të dytë të Projektligjit për rregulla të reja në trafik. Pro projektligjit kanë votuar 61 deputetë. Ministri thotë se nëpërmjet këtij ligji përcaktohen rregullat bazë të sjelljes së pjesëmarrësve dhe subjekteve të tjera në trafikun rrugor. "Ligji aktual ka zbrazëtira ligjore si në aspektin e harmonizimit me AQUIS të BE-së, si në ato të Konventave Ndërkombëtare, si Konventa e Gjenevës (1945) dhe Vjenës (1968) për Trafikun Rrugor. Në vijim janë paraqitur ndryshimet e domosdoshme nëpërmjet këtij



Projektligji: Transpozon pjesërisht me Direktivën 2015/413 të datës 11.03.2015 që ka të bëjë me lehtësimin e shkëmbimit të informative ndërkombëtare në çështjet e gjobave të lidhura me sigurinë në trafik; Në përgjithësi janë rritur

shumat e gjobave për kundërvajtje në trafik. Kundërvajtjet në trafik janë të përshkallëzuara; Janë të përcaktuara dispozitat e trafikut të cilat e rregullojnë trafikun e trotineteve elektrike", ka shkruar Aliu në "Facebook".

Ai ka theksuar më tutje se pjesë e këtij projektligji janë edhe dispozitat që rregullojnë veprimet në autoudhë ku parashihen ngritjet e gjobave për shkak të rrezikshmërisë. "Dispozitat për drejtimin e mjetit motorik ku janë përshkallëzuar gjobat pa

patentshoferë dhe me patentshoferë jovalid. Përcaktimi i përdorimit të video-incizimeve si provë e shkeljeve nga pjesëmarrësit në trafik; Identifikimi i kundërvajtjes me pajisje elektronike për shqiptimin e gjobave elektronike; Bartja e përgjegjësisë tek pronari i automjetit, për rastin kur nuk mund të identifikohet shoferi i cili ka bërë kundërvajtje në trafikun rrugor; Dispozitat e veçanta ndaj shoferëve që ndosin rrugën me rrotat me baltë nga rruga e dheut, vendpunishtja dhe çfarëdo materiali që e ndotë rrugën; Rregullimi i dispozitave lidhur me çështjen e masës mbrojtëse 'ndalim i drejtimit të mjetit me veprim motorik' për përsëritësit e shkeljeve; Pasojat juridike të dënimeve janë rregulluar në mënyrë të detajuar", ka theksuar ministri Aliu.

## Kosova dhe Suedia theksojnë bashkëpunimin për rritjen ekonomike

PRISHTINË, 23 SHKURT - Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka pritur në takim ambasadorin e Suedisë në Kosovë, Jonas Westerlund

dhe zëvendëshefin e misionit, Henrik Riby. Gjatë takimit, ministrja Rizvanolli dhe përfaqësuesit e ambasadës suedeze kanë

diskutuar për zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe rritjen e bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve. Me theks të veçantë diskutuan

për potencialin ekonomik që ofron Kosova në fushën e minierave dhe forcimin e lidhjeve të Kosovës dhe të Suedisë në këtë sektor.





# Ndërtesat pasqyrojnë shpirtin e kohës

Nga: Moikom ZEQQ

Në Greqinë e lashtë arkitekti u njoh si “mjeshtër-ndërtues” (“archi-tekton”). Arkitektura u konsiderua “nëna” e arteve vizuale, meqë piktura dhe skulptura u zhvillua shpesh në kontekstin e një projekti ndërtimi, për shembull në formën e muraleve ose të dekoracioneve. Madje, pikturat e shpellave të kultit magjik shërbyen si zbukurime për banesat. Ndryshe nga format e tjera të artit, qëllimi parësor i arkitekturës ishte të përmbushte nevojën bazë njerëzore për siguri. Ndërtesat jepnin mbrojtje prej motit dhe kafshëve të egra. Kështu, është pothuaj e pamundur t'i shmangesh dëshmisë së veprimtarisë së ndërtimit aty ku njerëzit banonin.

Sidoqoftë, nevojat shpirtërore dhe intelektuale kanë gjithashtu për të lozur një rol kur vjen puna te ndërtimi. “Katër muret” dhe “çatia mbi kokën e tij/saj” e ndajnë një qenie njerëzore prej mjedisit rrethues dhe si pasojë krijojnë diçka me proporcione njerëzore individuale. Ndërtesat gjithashtu ndryshojnë mjedisin e jashtëm në të cilin ato ngrihen: kopshti, fshati dhe qyteti janë mjedise artificiale të shkëputura nga natyra. Kështu, mund të hamendësohet shumë rreth personit përgjegjës për një ndërtesë prej mënyrës se si paraqitet marrëdhënia midis pjesës së brendshme dhe të jashtme të ndërtesës. A ka ndërtesa mure të trasha të padepërtueshme apo mure të tejdukshme prej xhami? A krijojnë hyrjet, shkallët e jashtme, oborret e jashtme apo gardhet një ndjenjë hapjeje apo largësie?

Ngrihen gjithnjë disa pyetje të tjera: Kush i porositi ndërtesat? Kush i ndërton ato? Për kë dhe për çfarë qëllimi u ndërtuan? Çfarë farë forme marrin ato dhe ç'materiale u përdorën? Jo të gjithë ndërtesat janë punë të lavdërueshme që synojnë të bëjnë përshtypje me madhësinë, vëllimin, stilin dhe detajin e tyre dekorativ.

Megjithatë, të gjitha ndërtesat pasqyrojnë shpirtin e kohës së tyre, ose të paktën atë të njerëzve që i porositen ato dhe të arkitektëve që i projektuan ato. Më tepër se çdo krijim tjetër njerëzor, një ndërtesë përfaqëson kontekstin social: ndërtesa është një akt social, i cili pothuajse gjithmonë zë vend në arenën sociale. Ajo është një veprimtari e shtrenjtë dhe si rrjedhim është e varur prej fuqisë dhe pasurisë.

Pra, ndërtimet e përpunuara tregojnë shumë për njerëzit dhe veprimtaritë e rëndësishme, për



grupet sunduese në një shoqëri të dhënë.

Nuk është e rastit që ndërtesat fetare lozin një rol të rëndësishëm në historinë e arkitekturës. Siç ka treguar historia, feja përmbush atë çka është mundësisht nevojë më e rëndësishme shpirtërore e njeriut, p.sh. nevojën për t'i dhuruar një kuptim (më të lartë) mbi ekzistencën, për të shpjeguar të pakuptueshmen dhe të padurueshmen, për të siguruar perspektiva të një drejtësie më të lartë për gabimet e pashlyera dhe të ofrojë rehatinë e jetës së vazhdueshme, rilindjen apo ringjalljen pas vdekjes.

Kështu, përveç sigurimit të strehës për njerëzit, që nga kohët e lashta banesat janë ndërtuar gjithashtu edhe për zotat. Duke u mbajtur me pozicionin e lartësuar të këtyre të fundit, këto ndërtesa prirën të jenë më të qëndrueshme dhe më impulsive se sa ato të ngritura për të vdekshmit e thjeshtë.

Si me qytetërimet e tjera të përparuara, pak mbetën prej banesave të zakonshme të ndërtuara prej egjiptianëve të lashtë. Të vetmet relike të ruajtura arkitekturale të Mbretërisë së Vjetër janë varret që shërbyen si vende të adhurimit.

Ekzistenca e Egjiptit varej prej Nilit, përmytjet vjetore të të cilit linin pas një shtresë lymi pjellor dhe, duke mos qenë shkatërruese, ishin si pasojë jetëdhënëse. Botëvështrimi i njerëzve që jetonin nga kjo rrjedhë e qetë u përcaktua nga ky cikël i përhershëm. Vdekja shihej si një kalim te një formë tjetër jete dhe ky kalim ishte, sidoqoftë, i mundshëm vetëm nëse trupi mbetej i paprekur. Kështu, u bënë

përpjekje të mëdha për të ruajtur kufomat.

Më e madhja, natyrisht, u rezervua për trupin e faraonit, mbreti që njihej si një perëndi. Truri dhe të brendshmet u hoqën nga kufoma, e cila më pas përgatitej për varrim (nga kjo e kanë origjinën mumiet e famshme). Ushqimi dhe dhuratat e tjera u futën në varr. Për më tepër, muret e vendit të flijimit u zburuan me relieve të skenave të korjes dhe dhuratat flijuese në rastin kur “furnizimi” tretej.

Përkundër një sfondi të kushteve të pandryshueshme rituale dhomat e tjera u ndërtuan shpesh rreth dhomës së flijimit në mënyrë që personi i vdekur të mos privohej prej nivelit të tij/saj të rehatisë. Dhomat e flijimit u ndërtuan gjithnjë në bregun më të lartë perëndimor të Nilit përmbi dhomën e vërtetë të varrimit, që ishte fshehur thellë në shkëmb.

Shtëpi të tëra, pallate dhe madje qytete, në të cilat personi i vdekur kishte banuar, shpesh u riprodhuan. Kështu varri i faraonit Zoser, i ndërtuar në Sakara midis viteve 2780 dhe 2680 para Krishtit u konceptua si një riprodhim i pallatit të faraonit në Memfis, një bllok kompakt me gur gëlqeror të shkallëzuar apo me mure tulle. Pesë blloqe kënddrejta të dimensioneve zvogëluara u vendosën në majë të superstrukturës (mastaba) së Zoserit, siç u njohën këta varre prej blloqesh, kështu që kulla arriti një lartësi prej afro 60 metra.

Shkaku për ta vënë prapa hyrjes së piramidës mund të ketë qenë për të dhënë më tepër siguri për varrin (dhe për të garantuar që kufoma të mos shqetësohet), ose për ta

bërë varrin më të rëndësishëm. Fakti që prej atëherë varret e faraonëve u bënë monumente mund të shpjegohet ndoshta nga një dëshirë për t'i dhënë një formë vizuale simbolizmit fetar: piramida e shkallëzuar përfaqëson një shkallare të cilën faraoni i vdekur e ngjiste për të arritur qiellin.

Gjatë shekullit të tretë para Krishtit, faraonët nisën të shihen si bij të Diellit, zotit Ra, dhe adhurimi për Diellin u bë feja zyrtare. Piramidat, të cilat kishin përfutur ndërkohë një plan katror dhe mure të jashtme të lëmuara, si Piramida e Gizës kishin kolona të ndritshme të veshura me një shtresë prej guri gëlqeror dhe me shtresë ari (të dyja këto veçori u zhdukën nga gërryerja e kohës). Ato simbolizonin rrezet e diellit mbi të cilat besohej se faraonët ishin dërguar te perëndia Ra.

Në fillim të Mbretërisë së Vjetër, dhomat me tavane të cilët nuk mund të mbështeteshin vetëm mbi mure u mbështetën mbi shtylla të thjeshta katrore pa themele dhe kapitele.

Gjatë erës së Piramidave të shekullit të tretë para Krishtit këto shtylla u zëvendësuan nga kolona me kapitele të zburuara të frymëzuara nga zambaku, papirusi dhe pema e palmës. Kjo veçori projektimi, e zhvilluar më tepër për kult se sa për arsye strukturore, synoi të përçojë një kuptim të madhështisë dhe të vlerës së përjetshme dhe u bë një veçori tipike e ndërtesave në Egjiptin e Lashtë.

Arkitektura e Mbretërisë së Re, një periudhë e veprimtarisë së begatë arkitekturore që zgjati prej vitit 1570 deri në vitin 715 para Krishtit, u dominua nga komplekset e

kultit aksial me salla të mëdha me kolona, të ngjashme me ato të zbuluara në tempullin mortor të Deir el Baharit.

Tempujt e procesionit në luginën e Nilit u gdhendën në shkëmbinj në perëndim të Thebes dhe më të famshmit janë Tempujt e Amonit në Luksor dhe Karnak. Ato na tregojnë se perspektivat fetare dhe filozofike të arkitektëve projektues u influencuan nga peizazhi rrethues natyror. Kullat e pjerrëta të hyrjes, të njohura si pilons (shtylla), e mbajnë hyrjen në të njëjtën mënyrë që faja e shkëmbit e rrethon Nilin. Obeliskët dhe statujat monumentale qëndrojnë përballë hyrjes.

Prapa kësaj është një paraoborr i rrethuar nga vargje kolonash që të çojnë përmes një paradhome në një sallon të madh hipostyl (i varur), i mbushur dendur me kolona, kapitelet prej bimësh të të cilave të kujtojnë bimësinë përreth Nilit. Kompleksi përfundon me një dhomë të ngushtë, të thellë (“më e shenjta”) që përmban një imazh të zotit për të cilin tempulli është dedikuar si një shtëpi (tempujt e gdhendur në shkëmbinj ishin të ngjashëm përgjithësisht në strukturë).

Kur Mbretëria e Re e rriti begatinë, gjithnjë e më shumë paraoborre dhe kolona u shtuan përballë atyre ekzistuese. Procesionet që kaluan këto shtylla të shtuara në mënyrë të përsëritur u shumëfishuan pra prej kohës së tyre më tej në të kaluarën e madhe të vendit të tyre, roli i dalluar i të cilëve në zhvillimin e racës njerëzore përfundoi së mbrami me pushtimin e tij prej Aleksandrit të Madh në vitin 332 para Krishtit.

/Gazeta “Dita”/

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Muhamet Hyseni, 'Ylli i javës' në Superligën e futbollit

PRISHTINË, 23 SHKURT - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 21-të në Albi Mall Superligë i ka takuar futbollistit të FC Llapi, Muhamet Hyseni. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit në përbërje: Blerim

Haxholli, Selajdin Jerliu dhe Luan Tabaku. Ky komision vendosi që çmimi "Ylli i Javës" për xhiron e 21-të t'i takojë Muhamet Hysenit, lojtar i KF Llapi, pasi në fitoren kundër Fushë-Kosovës pati paraqitje shumë të mirë, duke realizuar një gol dhe një asistim në fitoren bindëse, 3-0. Për Hysenin ky është çmimi i katërt

në këtë edicion. Pasi mori këtë çmim futbollisti llapjan u shpreh i lumtur për vlerësimin. "Jam i lumtur që për herë të katërt nderohem me këtë çmim. Falënderues çdoherë për ata që më vlerësuan. Çmimin e ndaj me bashkëlojtarët. Meritat janë të përbashkëta, pasi futbollit është një sport kolektiv dhe pa

bashkëpunimin dhe ndihmën e tyre nuk do të mund ta fitoja këtë çmim. Falënderoj klubin e Llapit, në veçanti stafin e trajnerëve që po bëjnë një punë shumë profesionale dhe po na japin mbështetje të pazërvë. Punën po e vërtetojmë me paraqitje të mira në çdo ndeshje. Për mua është vetëm fillimi i një rrugëtimi të



suksesshëm. Nuk do të ndalem asnjë moment për suksese të reja. Forca Llapi! Forca legjenda", ka theksuar Hyseni për faqen zyrtare të FFK-së.

## KOK-u dhe MKRS-ja marrin hapa konkretë kundër diskriminimit të sportistëve të Kosovës në arenën ndërkombëtare

PRISHTINË, 23 SHKURT - Komiteti Olimpik i Kosovës ka organizuar të premten punëtorinë për luftën kundër diskriminimit në sport, përkatësisht diskriminimit të sportistëve dhe federatave sportive të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Në këtë punëtori është bërë me dije se qëllimi i saj është hartimi i një manuali që ka të bëjë me diskriminimin e sportistëve tanë në arenën ndërkombëtare.

Përfaqësuesja e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në këtë tryezë, Afërdita Fazliu, ka thënë për "KosovaPress" se ndër vite sportistët kosovarë janë diskriminuar në forma të ndryshme në evente ndërkombëtare sportive, andaj reagimi ndaj kësaj dukurie është shumë i nevojshëm. "Qëllimi i kësaj punëtorie është hartimi i një manuali që ka të bëjë me diskriminimin e sportistëve tanë në arenën ndërkombëtare. Është një prej projekteve të para të këtij

karakteri që bëhet duke pasur parasysh që kohën e fundit kemi pasur një mori të diskriminimeve që u janë bërë ose federatave sportive apo sportistëve në mënyrë individuale, kështu që ministria në bashkëpunim me Komitetin Olimpik kanë angazhuar një ekip të ekspertëve që kryesisht janë ekspertë që vijnë nga Italia dhe ekspertë të Komitetit Olimpik, për hartimin e një manuali i cili do të shërbejë në preventivë, por gjithsesi edhe për bashkërendimin e të gjitha institucioneve të cilat, pavarësisht në çfarë natyre janë organizimet apo ngjarjet në të cilat ekipet ose kombëtares e Kosovës diskriminohen, ne do të luftojmë me të gjitha mjetet edhe në aspektin sportiv, por edhe në atë diplomatik që sportistët tanë të jenë të barabartë me të gjithë sportistët e botës", ka thënë Fazliu. Ndërsa Blerina Imeri nga Departamenti Ligjor i Komitetit Olimpik të Kosovës ka deklaruar se Kosova është ndër vendet e para që



ka marrë një iniciativë të tillë. "Qëllimi i kësaj tryeze është detajimi i një manuali që jemi duke e punuar në proces e sipër me ekspertë ndërkombëtarë të cilët i kemi angazhuar. Janë avokatë me eksperiencë shumë të madhe ndërkombëtare në fushën e diskriminimeve që bëhen në sport. Ajo që më gëzoj është fakti se ekspertët në fjalë na njoftuan se Kosova është ndër shtetet e para e

cila e ka marrë një iniciativë të tillë, pra të punojë një manual që do t'u ndihmojë të gjitha organizatave sportive në vend që ta parandalojnë paraprakisht ndonjë lloj të diskriminimit që mund të ndodhë në të ardhmen në arenën ndërkombëtare ndaj sportistëve tanë siç kemi pasur raste të shumta që me disa federata si ajo e boksit, e karatesë, e futbollit", ka thënë Imeri. Sipas Imerit, ky manual do të

parashohë afate kohore për të reaguar në parandalimin e dukurisë së diskriminimit. "Komiteti Olimpik dhe ministria kemi për qëllim që në aspektin ndërkombëtar të veprojme në afatet e para, sapo të dëgjojmë që një sport, një federatë do të jetë pjesë e një aktiviteti i cili organizohet në njërin ndër vendet që potencialisht mund të kemi pengesa për pjesëmarrje apo për përdorim të simboleve tona, atëherë të reagojmë me kohë. Do të parashihen afatet, do të parashihen të gjitha procedurat hap pas hapi që federatat tona mund të fillojnë qysh në fillim të vitit kalendarik", ka shtuar Imeri.

Në këtë punëtori u vu në pah fakti se ndër vite shumë sportistë dhe federata janë diskriminuar duke u penguar të marrin pjesë në evente ndërkombëtare sportive për shkak të problemeve politike, telasheve me viza si dhe çështje të tjera. Në këtë punëtori ligjërues është avokati për çështje sportive nga Italia, Salvatore Civalo.

## Mësohen përballjet në Ligën e Evropës dhe në Ligën e Konferencës

NYON, 23 SHKURT - Në Nyon është hedhur shorti i 1/8-ve për 16 skuadrat më të mira të Ligës së Evropës në këtë sezon. Milani mund të cilësohet me fat, pasi shorti e ka vendosur përballë Slavia të Pragës, duke shmangur një përballje të mundshme me Liverpoolin apo Leverkusenin. Roma ndërkohë është shortuar me Brightonin e De Zerbit, në një duel që premton spektakël.



Liverpooli do të ketë dy duela me Spartën e Pragës, ndërkohë që Leverkuseni është shortuar ndaj Qarabag.

Marseille - Villarreal është një nga çiftet më të ndezura, ndërkohë që edhe Sporting - Atalanta është një duel për t'u parë. Të premten është hedhur shorti për ndeshjet e fazës së 1/8-tës në Ligën e Konferencës. Megjithatë, ndeshja më interesante padyshim se do të jetë ajo në mes të Ajaxit dhe Aston Villas. Ndeshje të tjera interesante do të jenë edhe ato në mes të Union SG - Fenerbahçe,

Maccabi Haifa - Fiorentina, Sturm Graz - Lille dhe Dinamo Zagreb - PAOK. Takimet e tjera të kësaj faze

janë: Servette - Viktoria Plzen, Molde Club - Brugge, Olympiacos - Maccabi Tel-Aviv.

### ÇIFTET E LIGËS SË EVROPËS

Sparta Praha - Liverpool  
Marseille - Villarreal  
Roma - Brighton  
Benfica - Rangers  
Freiburg - Eest Ham  
Sporting Lisbon - Atalanta  
Milan - Slavia Praha  
Qarabag - Bayer Leverkusen

### ÇIFTET E LIGËS SË KONFERENCËS

Servette - Viktoria Plzen  
Ajax - Aston Villa  
Molde - Club Brugge  
Union SG - Fenerbahçe  
Dinamo Zagreb - PAOK  
Sturm Graz - Lille  
Maccabi Haifa - Fiorentina  
Olympiacos - Maccabi Tel-Aviv

## Kurti: 'Dardanët' i dalin zot Kosovës

PRISHTINË, 23 SHKURT - Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll e ka nisur me fitore raundin e parë parakualifikues për Kupën e Botës 2027, pasi e ka mposhtur Irlandën. Përballja e luajtur në Pallatin e

Rinisë dhe të Sporteve në Prishtinë përfundoi me rezultatin 83:76. Këtë takim nga afër e përcolli edhe kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti. "Dardanët i dalin zot Kosovës! Në palestrën e

mbushur përplot të Pallatit të Rinisë dhe Sportit, në çerekun e fundit të lojës të gjithë ishim në këmbë në kërkim të fitores. 83 me 76 ishte rezultati fitues i basketbollistëve tanë ndaj Irlandës. Këtë të diel, e luajmë

ndeshjen e radhës si mysafir kundër Azerbajxhanit. Duke besuar në sukses, vazhdojmë me hapa të sigurt në rrugëtimin tonë për parakualifikimet e Kupës së Botës", ka shkruar Kurti.



## Dukagjini konfirmon transferimin e Zulfijit në Kazakistan

**KLINË, 23 SHKURT** - Skuadra e Dukagjinit të Klinës ka njoftuar se futbollisti i saj Iljasa Zulfiji është transferuar në Kazakistan, përkatësisht në skuadrën e Zhenis Astana. "Një prej lojtarëve më të rëndësishëm Iljasa Zulfiji, e përmbyll angazhimin e tij te

klubi ynë. Zulfiji është transferuar në 'Zhenis Astana', të Kazakistanit, klub që bën gara në Premierligën e atjeshme", thuhet në njoftimin e Dukagjinit. Klubi nga Klina më pas e ka falënderuar Zulfijin për kontributin e deritanishëm dhe i

dëshiron suksese në karrierë. Zulfiji në sezonin e parë (2022-2023) me Dukagjinin ishte një ndër lojtarët kyç që kontribuoi me 4 gola dhe 4 asistime. Historike ishte kur klubi u kualifikua në Ligën e Konferencës dhe Zulfiji ishte

golashënuesi më i mirë i ekipit me katër gola të shënuara dhe vendimtar në ndeshjet ndaj Europa FC dhe kalimin tutje në raundin e dytë të Ligës së Konferencës. Edhe në sezonin e dytë (2023-2024) Caja ka shënuar 4 gola për



ekipin, duke shënuar edhe në ndeshjen e fundit të tij të Dukagjinit ndaj Lirisë.

## Shqipëria më 3 qershor përballet me Lihtenshtejnin

**TIRANË, 23 SHKURT** - Kombëtarja e Shqipërisë do të luajë ndeshje miqësore në muajin qershor ndaj Lihtenshtejnit. Federata Shqiptare e Futbollit ka arritur akordin me Federatën e Lihtenshtejnit që ky takim të zhvillohet më 3 qershor 2024 në Austri. Orari dhe stadiumi do të përcaktohen në ditët në vijim. Sfidat miqësore janë në kuadër të përgatitjeve për Evropianin "Gjermani 2024".

FShF-ja fillimisht ka zyrtarizuar dy ndeshje miqësore që do të luhen në muajin mars ndaj Kilit (22 mars, stadiumi "Enio Tardini") dhe Suedisë (25 mars, stadiumi "Friends Arena"). Në ditët në vazhdim FShF-ja do të njoftojë edhe për biletat e ndeshjeve miqësore, duke nisur me dy sfidat e muajit mars ndaj Kilit dhe Suedisë. Përveç Lihtenshtejnit, FShF-ja po punon për ta zyrtarizuar edhe një miqësore tjetër për muajin qershor. Sa i përket takimit me Lihtenshtejnin, kjo do të jetë hera e katërt që dy përfaqësueset do të



përballet në një ndeshje futboll. Në të kaluarën Shqipëria i ka fituar të tri sfidat ndaj Lihtenshtejnit me rezultatin e njëjtë 2-0. Një ndeshje ka qenë miqësore dhe dy të tjera të vlefshme për eliminatorët e Kampionatit Botëror. Shqipëria do ta nisë rrugëtimin e saj në Kampionatin Evropian "Gjermani 2024" më 15 qershor ndaj Italisë. Sfidat do të luhen në orën 21:00 në

stadiumin "BVB Stadion Dortmund". Katër ditë më pas, më 19 qershor, kuqezinjët do ta luajnë ndeshjen e dytë të Evropianit kundër Kroacisë duke nisur nga ora 15:00, në stadiumin "Volksparkstadion Hamburg". Ndeshjen e fundit në Grupin B, Shqipëria do ta luajë ndaj Spanjës më 24 qershor në stadiumin "Dusseldorf Arena" në orën 21:00.

## Triumfojnë Bostoni, Denveri, Indiana dhe Golden State

**CHICAGO, 23 SHKURT** - NBA është rikthyer pas ndeshjes së All Star Game disa ditë më parë. Kampionët e Denverit fituan me rezultat 130-110 ndaj Washingtonit, një sfidë e dominuar nga vendasit, ku u dallua Nikola Jokiqi me një "triple double" (21 pikë, 19 rebounde, 15 asistime). Fitoi edhe Bostoni, që komandon renditjen e NBA-s dhe të Konferencës së



Lindjes. Ekipi i Celticsit mposhti me rezultatet 129-112 Chicagon jashtë fushës. White me 28 pikë dhe Tatum me 25 pikë bënë diferencën për skuadrën mike. Skuadra e Golden States, falë 32 pikëve të Stephen Curryt, mundi me rezultat 128-110 lakersat, ndeshje ku për miqtë mungoi James. Vijon sezoni pozitiv i Oklahomas, që mundi me rezultat 129-107 clippersat, sfidë ku

u dallua Alexander Shai me 31 pikë. Luka Donçiqi realizoi 41 pikë në fitoren e Dallasit, që mundi me rezultat 123-113 Phoenixin, duke qenë lider në fushë. Skuadra kanadeze e Torontos mundi me rezultat 121-93 Brooklyn, ndeshje ku u dallua Trent me 25 pikë, ndërsa Indiana mundi me rezultat 129-115 Detroitin, me Haliburton protagonist (25 pikë).

### REZULTATET

Cleveland - Orlando	109-116
Indiana - Detroit	129-115
Philadelphia - New York	96-110
Toronto - Brooklyn	121-93
Dallas - Phoenix	123-113
Chicago - Boston	112-129
New Orleans - Houston	127-105
Oklahoma - Clippers	129-107
Denver - Washington	130-110
Utah Jazz - Charlotte	107-115
Golden State - Lakers	128-110
Sacramento - San Antonio	127-122

### SHKURT

#### Silva: Kemi besim në Brojën, por duhet ta pres rastin e tij

Trajneri Marko Silva ka folur për sulmuesin Armando Broja, i cili në janar u transferua te Fulhami, me shpresën që të kishte më shumë minuta. Në fillim Broja shihet si një bekim për ekipin e Fulhamit, por sulmuesi kuqezij është aktivizuar vetëm disa minuta. Rivaliteti i fortë në fazën sulmuese, por dhe kushtet e tij fizike jo perfekte, kanë ndikuar shumë. "Broja duhet ta presë radhën e tij. Ne vërtet besojmë se ai është lojtar i duhur këtu. Ai erdhi në ditën e fundit të merkatos përpara ndeshjes me Berlinin dhe ka luajtur 20 minuta, por Rodrigo shënoi, dhe më pas në ndeshjen tjetër, realizoi dy gola të tjerë. Në javën e kaluar, për fat të keq, ai nuk ishte mirë me shëndetin dhe humbi ndeshjen. Tani ai është në formë dhe gati për të luajtur. Armando po punon shumë në një klub të ri, me një stil të ndryshëm loje, dhe i duhet kohë për të përshtatur dhe për të kuptuar gjërat. Ne kemi besim në aftësitë e tij", është shprehur trajneri i Fulhamit.

#### Erikseni në verë rikthehet tek Ajaxi

Christian Eriksen në afatin kalimtar të verës do të rikthehet te skuadra e Ajaxit. 32-vjeçari po gjënjë pak hapësira në formacionin e Erik ten Hag, prandaj mundësia e largimit është e madhe. Futbollisti danez ka luajtur edhe për Interin, kurse kontrata e Eriksenit me "djajtë e kuq" skadon më 30 qershor 2025, por duket se ka shumë mundësi që aventura e tij në United të përfundojë më herët se afati i caktuar. Erikseni iu bashku Ajaxit në vitin 2007, kurse në vitin 2013 u largua dhe iu bashkua Tottenham Hotspurit.

#### 'Adidas' shtyn Wirtzin të nënshkruajë për Realin

Florian Wirtz është ylli kryesor i Bayer Leverkusenit. Mesfushori 20-vjeçar gjerman ka shënuar 8 gola dhe ka dhënë 16 asistime në 30 ndeshjet e tij këtë sezon në të gjitha kompeticionet. Kjo do të thotë se skuadrat e mëdha në Evropë e kanë tashmë në radarin e tyre. Lojtari, sipas "Bild", nuk dëshiron të largohet nga Leverkuseni deri në vitin 2025, ndaj duket e vështirë për të nënshkruar me të këtë verë. Bayern Muncheni sakaq e ka atë si objektivin kryesor, por Leverkuseni nuk dëshiron t'ia shesë yllin rivalit të tij më të madh. Nisur nga kjo situatë, "Adidas", sponsori i tij kryesor, është futur në lojë duke shtyrë mesfushorin të nënshkruajë për Realin e Madridit duke nisur që nga viti 2025, të cilin momentalisht Leverkuseni e vlerëson 130 milionë euro.

#### Vetëm pesë futbollistë e kanë vendin e sigurt në Bayern

Bayern Munchen po kalon një sezon aspak të mirë dhe ndryshimet në fund të kampionatit pritet të bëhen nga drejtuesit e klubit. Trajneri Thomas Tuchel do të largohet, kurse mediet në Gjermani raportojnë se vetëm pesë futbollistë janë të paprekshëm, kurse të tjerët mund të largohen. Futbollistët që pritet të jenë pjesë e gjigantit gjerman edhe në edicionin e ri janë Joshua Kimmich, Harry Kane, Manuel Neuer, Thomas Muller dhe Jamal Musiala. Bayerni është eliminuar nga Kupa, derisa me gjasë do ta humbasë edhe garën për titull, kurse në Ligën e Kampionëve ka pësuar humbje në ndeshjen e parë nga Lazio (1-0).

## Rusia mbetet jashtë Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, i refuzohet ankesa

Apelimi i Rusisë kundër vendimit të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (IOC) për ta pezulluar anëtarësimin e tij është hedhur poshtë nga Gjykata e Arbitrazhit Sportiv (CAS). IOC pezulloi Komitetin Olimpik Rus (ROC) "me efekt të menjëhershëm" në tetor për "një

shkelje të kartës olimpikë", raporton BBC. ROC njohu organizatat rajonale nga katër territore ukrainase të aneksuara ilegalisht nga Rusia që nga fillimi i invazionit të saj në shkallë të plotë më 2022. Pezullimi nga IOC do të thotë që ROC nuk ka më të drejtë të funksionojë si një

komitet kombëtar Olimpik. "Paneli i Cas i ngarkuar me këtë çështje hodhi poshtë ankesën dhe konfirmoi vendimin e kundërshtuar, duke gjetur se bordi ekzekutiv i IOC nuk ka shkelur parimet e ligjshmërisë, barazisë, parashikueshmërisë ose proporcionalitetit".

"Vendimi i panelit të Cas është përfundimtar dhe detyrues, përveç të drejtës së palëve për të paraqitur një ankesë në Gjykatën Federale të Zvicrës brenda 30 ditëve me bazë të kufizuar". Këshillat olimpikë nga rajonet e Luhanskut, Donetskut, Khersonit dhe Zaporizhzhias

ishin njohur nga ROC. Në dhjetor, IOC njoftoi se atletët rusë dhe bjellorusë që janë kualifikuar për Lojërat Olimpikë Paris 2024 do të lejohen të marrin pjesë si neutralë. Kushtet e përfshirjes së tyre përfshijnë konkurrimin pa flamuj, stema apo himne të vendit të tyre.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada-Government  
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Numër: 240/1  
Datë: 23.02.2024

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPAR), në bazë të nenit 13 Ligjit të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/26 Mars), në bazë të Ligjit Nr. 04/1-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ nr. 14/2014, Udhëzimit Administrativ nr. 02/2016, si dhe në bazë të kërkesës te dt. 22.02.2024 me nr. 377 së **QeK "Shtjefën Gjeçovi" - Prishtinë** shpall:

## Ftesë për ofertë

**Për ekskursion të maturantëve të QeK "Shtjefën Gjeçovi" - Prishtinë, në Republikën e Shqipërisë**

**Ftojmë ofertuesit e kualifikuar (Agjensionet turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarfë të mbyllur.**

**Agjensioni turistik duhet t'i plotësojë këto parakushte:**

- Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve (Certifikata e biznesit).
- Certifikata e TVSH-së.
- Të jetë i licencuar sipas procedurave ligjore.
- Dëshmia e kontrollit teknik të automjetit sipas procedurave ligjore, dhe të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës.
- Autobusët të jenë komfor dhe me klimë.
- Agjensioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit.
- Agjensioni duhet të ketë të pajisur shoferët me kompetencën profesionale (CPC)
- Certifikata e autobusit sipas Licencës "D";
- Agjensioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënës dhe dëshmi (Certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit;
- Lloji i transportit (Autobus);
- Agjensioni turistik duhet te ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve;
- Agjensioni duhet të ketë një dëshmi për marreveshje me hotelin ku mendon me i derguar nxënësit ( **KDSH ka përcaktuar datat nga 16, 17,18,19,20.04.2024- katër netë, dhe preferon vendosjen në kompleksin Hotel Bonita - Durrës**).
- Agjensioni duhet të prezantojë dëshmi: menynë ditore të plotë për secilën ditë të ekskursionit.
- Agjensioni turistik duhet t'i përmbahet itinerarit të cilin e ka përcaktuar Këshilli Drejtues i shkollës
- Agjensioni duhet të garantojë me dëshmi (deklaratën nën betim nga OE), se do t'i mbulojë të gjitha shpenzimet gjatë vizitave në monumentet kulturo-historike.
- Agjensioni duhet të na ofrojë siguri (deklaratë nën betim nga OE), në hotele dhe gjatë vizitave që do tu bëhen monumenteve kulutor-historike.
- Agjensioni do të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tri vitet e fundit (2021-2022-2023)
- Agjensioni duhet të ofrojë një listë me emrat e shoferëve që do të marrin pjesë në ekskurzion, kategorinë e patentë shoferit, llojin e autobusit, vitin e prodhimit, numrin e ulëseve dhe targat e autobusit që do të vozisin.
- Agjensioni duhet të ofrojë listën e shoferëve dhe punëtorëve të deklaruar në ATK, që do të marrin pjesë në ekskursion.
- Te gjitha dokumentet e kërkuara duhet të jenë origjinale ose fotokopje te vërtetuara!

### Kushtet tjera:

- Të sigurohet pansioni i plotë. Gjatë udhëtimit nëpër qytete racioni i rregullt mund të zëvendësohet me ushqim të thatë,
- Pamvarësisht numrit të nxënësve për paralele, kujdestarët e klasave shkojnë falas në ekskursion,
- Hoteli të posedojë sallë për ballo,
- Agjensioni të merr përsipër pagesën e vizitave monumenteve kulturo historike
- Të ketë komoditet gjatë udhëtimit (autobusë me kondicioner),
- Mundësi vizite në qytetet: Tiranë, Durrës, Krujë, Berat, Vlorë etj.

### Vlerësimi i ofertave:

Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2016 në ambientet e AAAPAR në Prishtinë.

Kriter për përzgjedhjen e kompanisë turistike do të jetë oferta më e përshtatshme ekonomike:

- Çmimi ofertues
  - Lloji i Hotelit (kategoria e hotelit në bazë të yjeve, nr. i nxënësve nëpër dhoma etj)
  - Menyja
  - Numri i nxënësve që udhëtojnë falas
  - Gjendja teknike e autobusëve
  - Referencat
- Vlerësimi i ofertave do të bëhet në ditën e mbylljes së shpalljes së ofertës pas orës 16:00.

Pas vlerësimit të ofertave nga komisioni, publikimi i përfutjesit do të shpallet në tabelën e shpalljeve në hyrje te shkollës.

Aplikuesit e interesuar ofertat e veta duhet t'i paraqesin në dy zarfë (në zarfën e vogël oferta e mbyllur e futur në zarfën e madhe e cila përmban dokumentacionet e kërkuara nga shkolla). Ofertat dorezohen në zyret e AAAPAR në Prishtinë (Rruga "Agim Ramadani" p.n. ndërtesa MASHTI II, në katin e tretë, në objektin përball Fakultetit Ekonomik dhe Juridik në Prishtinë)  
Data e nisjes mund të ndryshojë (plus-minus nje ditë), ndërsa agjenda mund të ndërrojë varësisht nga kërkesa e udhëheqësit të ekskursionit.

**Afati i paraqitjes së ofertave është shtatë ditë nga dita e shpalljes në gazetën ditore.**

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "RHEUMACTIVA PLUS" Sh.P.K. me seli në Podujevë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811862483 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "RHEUMACTIVA PLUS" D.O.O. od Podujeva, donelo odluku o prestani rada sa nrb: 811862483 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "RHEUMACTIVA PLUS" L.L.C. with headquarters Podujeva, has come to the decision to quit its business: 811862483 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjejpunesheite](http://www.facebook.com/gjejpunesheite)


## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

## &gt;&gt; SHPALLJE TË VOGLA &lt;&lt;

- Dashmir Duraku nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Kristian Hajdari nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl.10.11.12 dhe diplomën e sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Makineri-Automekanike Gjakovë.

- Joni-C SH.P.K. shpall të humbur certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810136011.

- N.T.P. "Al&Doni" Kujtim Gërbeshi B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e Biznesit me nrb: 810525347.

- Arjeta Kryeziu shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Mic Sokoli" Lubeqevë.

- Bajram Spahi shpall te pavlefshme 2 dëftesat Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Gentian Hoti shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu "Bajram Curri" Krushë e Madhe.

- Blerim Badalli shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Nuhi Rexhepi shpall te pavlefshme dipllomen Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Hami Ramadan Bajraliu shpall të pavlefshme Diplomën e Universitetit të Prishtinës, drejtimi Ekonomik me nr. 742.

- Anita Uka shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore nga kl. parë deri të nëntën të shkollës "Nazim Gafurri" Prishtinë.

- Naser Shunjaku nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike "Nexhmedin Nixha".

- D.P.H. "Burimi" shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330286147-Gjilan.

- Bulent Bytyqi shpall te pavlefshme 4 dëftesat shme "Ymer Prizreni" Prizren.

- Fikret Ajazaj shpall te pavlefshme diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren.

- Egzona Rustemi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. dhjetë (X), njëmbëdhjetë (XI) dymbëdhjetë (XII) si dhe Diplomën e Gjimnazit "Naim Frashëri" Shtime.



**VIDAS**  
Llatte drink 2%  
TAMËL 2,87  
Schmand 18% yndyrë 800g  
100% Fresh & Natural  
JOGURT 100% Fresh & Natural  
DHALLË 100% Fresh & Natural

**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992

